



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN KOSOVO
ODA EKONOMIKE AMERIKANE NË KOSOVË / AMERIČKA PRIVREDNA KOMORA NA KOSOVO

ALTERNATIVE DISPUTE RESOLUTION CENTER
QENDRA PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË KONTESTEVE/ CENTAR ZA ALTERNATIVNO REŠAVANJE SPOROVA

Ndërmjetësimi në dhjetë pyetje

AmCham
Qendra ZAK

With the support of



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Ndërmjetësimi në dhjetë pyetje

1. Çfarë është ndërmjetësimi?

Ndërmjetësimi është formë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve i cili ka si qëllim që me asistencën profesionale të ndërmjetësuesit dhe të Qendrës për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve të Odës Ekonomike Amerikane (Qendra ZAK) të mundësojë gjetjen e një zgjidhje të pranueshme nga të dy palët. Ndërmjetësimi është shumë i lirë, profesional, i shpejtë dhe efikas, dhe marrëveshja e arritur ka fuqi ekzekutive.

2. Cila është fuqia ligjore e marrëveshjes së ndërmjetësimit?

Në rast se arrihet marrëveshja e ndërmjetësimit mes palëve në mosmarrëveshje, kjo marrëveshje është titull ekzekutiv, me fuqi të njejtë sikurse vendimi i përbarueshëm i gjykatës. Kjo nënkupton se nëse njëra palë nuk e respekton marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim, pala tjetër nuk ka nevojë të paraqesë padi as në gjykatë e as në arbitrazh. Marrëveshja e ndërmjetësimit përbarohet drejtpërdrejtë nga ana e përbaruesve privat, dhe atë në mënyrë të shpejtë dhe mjaft efikase.

3. A mund të imponohet një marrëveshje për ndonjë palë? A mund të ketë vendim nga një palë e tretë?

Një prej parimeve kryesore të procedurës së ndërmjetësimit është se nuk mund të ketë vendime të imponuara për palët, as nga ndërmjetësuesi, as nga Oda Amerikane, e as nga ndonjë palë e tretë. Ndërmjetësimi përfundon suksesshëm vetëm kur të dy palët pajtohen me propozimet e ndërmjetësuesit.

4. Pse preferohet ndërmjetësimi, cilat janë përparësitë e tij?

Ndërmjetësimi bën pjesë në grupin e Zgjidhjeve Alternative të Kontesteve dhe është i dizajnuar që t'i ndihmoj bizneset që mospajtimet eventuale ti zgjidhin shpejt dhe pa shpenzime duke shfytëzuar profesionalizmin e ndërmjetësuesit. Avantazhe tjera të ndërmjetësimit janë kosotoja shumë më e lirë se e arbitrazhit apo procedurave gjyqësore, titulli ekzekutiv i marrëveshjes së ndërmjetësimit, zhvillimi i shpejtë dhe efikas i procedurave, dhe fakti se gjithçka mbetet e fshehtë duke ruajtur kështu sekretet tregtare të kompanive.

5. Çfarë nëse ndërmjetësimi nuk ka sukses?

Nëse gjatë ndërmjetësimit nuk arrihet marrëveshje atëherë procedura shpallet e mbyllur. Në këto raste është e zakonshme që palët mosmarrëveshjen e tyre ta zgjidhin përmes arbitrazhit apo gjykatave si procedura ku ka një vendim përfundimtar nga një palë e tretë. Qendra ZAK sygjeron që si hap të dytë palët të parashohin arbitrazhin, për shkak të përparësive të shumta ndaj gjykatave. Megjithatë, duhet të theksohet se në ndërmjetësim shkalla e suksesit dhe arritjes së marrëveshjeve është shumë e lartë.



6. Si mund të vijmë në ndërmjetësim?

Për ta zgjidhur një mosmarrëveshje përmes ndërmjetësimit duhet të ekzistojë pajtimi i palëve. Pajtimi për të ndërmjetësuar rastin mund të jetë në dy forma, mënyra e parë është të parashikoni përmes kontratës që në rast se lindin mosmarrëveshje ato të zgjidhen përmes ndërmjetësimit, dhe mënyra e dytë është që pasi të lind mos-marrëveshja të arrihet pajtimi i të dy palëve që të ndërmjetësohet. Për shkak se pas lindjes së mosmarrëveshjes zakonisht palët nuk i ruajnë marrëdhëniet e mira në mes tyre, preferohet që klauzola e ndërmjetësimit me arbitrazh të parashikohet që në fillim në kontratë, duke e bërë ndërmjetësimin e obligueshëm për palët.

Qendra ZAK sygjeron këtë klauzolë për kontrata:

“Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, ose pretendim që del nga apo në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë shkeljen, ndërprerjen ose pavlefshmërinë e kontratës, palët pajtohen që fillimisht të provojnë ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit në kuadër të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë në pajtim me rregullat e Ndërmjetësimit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Nëse nuk arrihet marrëveshje brenda 30 ditëve, apo ndërmjetësimi dështon më herët, palët do ta zgjidhin rastin përmes arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Amerikane në pajtim me rregullat e Arbitrazhit në fuqi.”

7. Si caktohen ndërmjetësuesit të cilët angazhohen në ndërmjetësimin e rastit?

Ndërmjetësuesit të cilët angazhohen në ndërmjetësimin e rastit duhet të jenë tërësisht të pavarur nga rasti dhe nga palët në mosmarrëveshje, duhet të jenë ekspertë të fushës ku vendosin, dhe të kenë integritet të lartë profesional dhe moral, dhe të kenë përfunduar trajnimet e specializuara për ndërmjetësues.

Forma e zakonshme e emërimit të ndërmjetësuesit është që të dy palët të pajtohen për një emër specifik të cilit i besojnë. Në rast se nuk arrihet kjo, atëherë është vetë Qendra ZAK e cila bën caktimin e një ndërmjetësuesi, bazuar në natyrën e rastit, palët, dhe faktorë tjerë që do të ndikojnë që më lehtë të arrihet deri te marrëveshja.”

8. Sa është i përhapur ndërmjetësimi në botën e biznesit?

Ndërmjetësimi është term standard në shumicën e kontratave komerciale në botën e biznesit. Kjo për arsye se shumica e mosmarrëveshjeve shumë lehtë mund të zgjidhen nën asistencën e ndërmjetësuesve profesional, me të cilën zgjidhje të gjithë janë të kënaqur. Zakonisht klauzola e ndërmjetësimit specifikon që në rast të dështimit të ndërmjetësimit rasti përfundon në arbitrazh, përmes të cilës u bëhet presion palëve që të jenë serioze në ndërmjetësim në gjetjen e zgjidhjeve.



9. Sa përdoret ndërmjetësimi nga bizneset në Kosovë dhe çfarë përvoje ka Qendra ZAK në menaxhimin e suksesshëm të rasteve të tilla?

Është një numër i konsiderueshëm dhe në rritje të kompanive jo-anëtare dhe anëtare të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë të cilat janë duke shfrytëzuar shërbimet e ndërmjetësitit dhe arbitrazhit, dhe të cilat parashohin një mekanizëm të tillë në kontratat e tyre. Gjithashtu, Qendra ZAK ka menaxhuar në mënyrë shumë profesionale dhe të sukseshme një numër të rëndësishëm të rasteve.

10. Kush mund ta përdor ndërmjetësimin pranë Qendrës ZAK të Odës Ekonomike Amerikane?

Nuk është e nevojshme që të jeni anëtar i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë që të përdorni shërbimet e ndërmjetësitit. Secila kompani e cila ka klauzolën e ndërmjetësitit e që specifikon ndërmjetësimin pranë OEAK-së mund të përdor këto shërbime. Si kompanitë anëtare të OEAK-së si ato që nuk janë kanë trajtim të barabartë.

Ky publikim u mundësua nga USAID



Ky artikull është përgatitur nga Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (Qendra ZAK) me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në kuadër të programit “Ngritja e Kapaciteteve për Qendrën ZAK”. Përmbajtja e këtij artikulli nuk pasqyron medoemos pikëpamjet e (USAID) apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Materialet dhe opinionet e ofruara në këtë dokument janë vetëm për informim të përgjithshëm, dhe nuk mund të përdoren si këshillë ligjore apo profesionale, nuk duhet të konsiderohen si zëvendësim për këshilla profesionale dhe ligjore për raste specifike.”

Sekretariati i Qendrës ZAK

Perandori Justinian St. No. 16 I 10 000 Prishtina, Kosovë
Phone +381 38 609 012
adrcenter@amchamksv.org
www.adr-ks.org

Sekretariati ofron asistencë profesionale në lidhje me përdorimin e arbitrazhit. Për informata shtesë apo ndihmë ju lutem na drejtohuni në adresat më lartë.